NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 29.10.2026

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor me masën "Ulja e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit ndaj prokurores S.Q.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka nisur hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates S.Q., prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për mosrespektim të rëndë ose të përsëritur të legjislacionit procedural dhe material, ose zbatimin e gabuar të tij, të konstatuar nga një gjykatë më e lartë.

Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit disiplinor, ILD ka konstatuar se magjistratja S.Q. ka kryer disa veprime dhe mosveprime që përbëjnë shkelje disiplinore:

- Prokurorja ka refuzuar të përcjellë informacionin e kërkuar nga Gjykata e Apelit, duke u mbështetur në argumentin e ruajtjes së sekretit hetimor. Ky qëndrim është vlerësuar nga gjykata si zbatim i gabuar i legjislacionit procedural penal, me pasoja të drejtpërdrejta në vlerësimin e masës së sigurimit, të cilësisë së hetimeve të kryera deri në atë fazë dhe të kërkesës objekt shqyrtimi.
- Veprimet dhe mosveprimet kanë ndikuar në administrimin e drejtësisë, duke kufizuar mundësinë e Gjykatës së Apelit për t'u shprehur mbi të gjitha shkaqet e paraqitura në ankim, në një çështje që lidhej drejtpërdrejt me të drejtën themelore të individit për liri.
- Nga prokurorja është konstatuar vijimi i të njëjtit qëndrim lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave procedurale për ruajtjen e sekretit hetimor, edhe në kuadër të vlerësimit të rrethanave rënduese.
- Mosveprimi i magjistrates nuk lidhet me mungesën e aftësive profesionale, por përbën një sjellje të drejtpërdrejtë dhe të vullnetshme, pasi pavarësisht eksperiencës jo të gjatë si prokurore, eksperienca profesionale e mëparshme dëshmon njohuri mbi përgjegjësitë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të magjistratit në raport me palët në proces.
- Sjellja e magjistrates ka cenuar imazhin e sistemit të drejtësisë dhe besimin e publikut në administrimin e tij, duke rrezikuar të krijojë precedent negativ edhe për magjistratë të tjerë, duke nxitur përsëritjen e praktikave të papërshtatshme në raste të ngjashme.

Raporti hetimor i ILD nënvizon se respektimi i ligjit dhe i rregullave procedurale përbën një detyrim thelbësor për çdo prokuror. Ushtrimi i këtij funksioni duhet të karakterizohet nga paanshmëria, objektiviteti dhe drejtësia, duke garantuar të drejtat e palëve dhe zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve cenon sigurinë juridike, dëmton besimin e publikut te Prokuroria dhe mund të pengojë gjykatat në ushtrimin efektiv të kompetencave të tyre.

Për këto arsye, ILD-ja ka arritur në përfundimin se veprimet dhe mosveprimet e magjistrates S.Q., të vlerësuara në tërësi, përbëjnë *shkelje të rëndë disiplinore* dhe i ka propozuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin e masës disiplinore *"Ulja e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit",* në bazë të nenit 102, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.